

09.02.2021

Ora 17:40

RENDI I DITËS

**Projektakti “Për kriteret e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të
Votave”.**

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
- **Ilijan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Komisioni Rregullator:**
- **Ilijana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ Y.Merkaj, A.Tenolli, M.Koja**
- **Parti Politike PD, LSI, PDIU**
- **Vëzhgues:**

Znj.I.Nano: Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator, janë të pranishëm në mbledhjen e sotme të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, është i pranishëm Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve zoti Celibashi, përfaqësues të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësues të partive politike të akredituara pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në rendin e ditës së mbledhjes së sotme kemi vetëm një çështje, domethënë një akt për të shqyrtuar. Projektudhëzimin: “Për kriteret e caktimit dhe organizimit për vendin e numërimit

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.09.02.2021*

të votave”.Edhe ky akt në vijim të akteve që ky Komisioni Rregullator po miraton në kuadër të përgatitjeve për procesin e ardhshëm zgjedhor, duke patur parasysh që ditët janë duke, jemi duke numër nga fundi le të themi sepse data e zgjedhjeve është duke u afruar. Si zakonisht duhet tja japim fjalën Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për të prezantuar projektaktin dhe më tej do të vijojmë me diskutimet lidhur me të. Zoti Celibashi ju lutem keni fjalën!

Z.I.Celibashi: Faleminderit zonja Nano! Atëherë, ky akt vjen në përmbushje të detyrimeve që përcakton neni 93 dhe neni 94 i Kodit Zgjedhor, në lidhje me vendndodhjen dhe organizimin e Vendit të Numërimit të Votave dhe caktimin e numrit të tavolinave të numërimit për çdo Vend të Numërimit të Votave. Me pak fajë gjithë qëllimi i këtij akti është që të ofrojën një skemë të organizimit të Vendit të Numërimit të Votave por më së pari të vendndodhjes së Vendit të Numërimit të Votave, me qëllim të garantimit të një procesi, të numërimit të votave, të nxjerrjes së rezultatit sa më transparent për ti krijuar akses dhe mundësi të gjitha palëve të interesuara më së pari subjekteve zgjedhor por edhe gjithë të tjerëve të interesuar për të parë nga afër dhe për të mbikqyrur procesin e numërimit të fletëve të votimit dhe të nxjerrjes së rezultatit. Duhet të themi që KQZ ka një eksperincë tashmë të konsoliduar në lidhje me, qoftë vendndodhjen e Vend Numërimit të Votave po ashtu edhe më mënyrën e organizimit së brendshëmi të Vend Numërimit të Votave, vendosjen e tavolinave të grupeve të numërimit, vendosjes së infrastrukturës që mundëson evidentimin e procesit të numërimit të fletëve të votimit. Nuk është se ka ndonjë ndryshim thelbësor nga aktet e tjera të ngjashme të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në kuptim të procedurave të numërimit të fletëve të votimit dhe të nxjerrjes së rezultatit. Pak a shumë është e njëjta skemë e organizimit të Vend Numërimit të Votave. Faleminderit!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.09.02.2021*

Znj. I. Nano: Faleminderit! Pas prezantimit të projektaktit nga ana e Komisionerit, unë do të çelja diskutimin në parim lidhur me projektaktin. Po i drejtohem së pari kolegëve, anëtarëve të Komisionit Rregullator më tej fjalën do ta kenë edhe përfaqësuesit e Partive Politike. Të nderuar kolegë lidhur me projektaktin në parim nëse keni ndonjë diskutim? Shoh që nuk ka diskutime nga kolegët! Përfaqësuesit e partive politike ju lutem! Zoti Kaso? Zoti Kaziaj? Nuk keni! Në rregull faleminderit! Atëhere meqenëse nuk kemi diskutime në parim, unë do t'iu ftoja ta votojmë në parim projektaktin "Mbi kriteret dhe përcaktimin dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave", të nderuar kolegë kush është dakord në parim me këtë projektakt. Zonja Vukaj?

Znj.H.Vukaj: Nuk dëgjoheni fare zonja Nona, ju dëgjoj më shkëputje dhe unë deri tani nuk kam marrë asnjë informacion, nuk po kuptojë se në cilën pikë jemi?

Znj. I. Nano: Jemi në votimin në parim të projektaktit.

Znj.H.Vukaj: Në parim?

Znj. I. Nano: Po.

Znj.H.Vukaj: Dakord!

Znj. I. Nano: Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj,z.Çakaj)

Kundër: S'ka!

Miratohet!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*


*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.09.02.2021*

Fillojmë atëherë, diskutimin nen për nen! Sipas rregullores unë duhet në diskutimin nen për nen unë duhet t'ia jap fjalën përfaqësuesve të partive politike, por personalisht kam një propozim që lidhet së pari me titullin e projektaktit. Projektakti ka ardhur në formën e një projektudhëzimi për kriteret e caktimit dhe organizimit të vendit të numërimit të votave. Nëse do të referohemi përmbatjes së projektaktit madje që në nenin e parë, qëllimi përcaktimi i rregullave. Ne si Komision Rregullator si aktet bazë tonat kemi vendimet, kështu që personalisht do të propozoja një ndryshim në titull dhe ndryshim në nenet vijuese aty ku përmendet fjala “projektudhëzim”ose “udhëzim” ta zëvendësonim me “projektvendim dhe “vendim”. Pra, duke qenë se propozimi vjen që tek titulli pa kaluar tek nenet me rradhë, nëse kolegët kanë ndonjë koment lidhur me propozimin tim? Po zoti Çaka!

Z.D.Çaka: Edhe unë personalisht mbështes propozimin tuaj. Duke u nisur në rradhë të parë edhe nga vetë përmbatja e dispozitave të Kodit Zgjedhor rrejedhimisht neni 93 të tij duke përcaktuar si dhe aktet që miraton Komisioni Rregullator janë vendimet por ashtu siç edhe ju cituat edhe nga vetë përmbatja e aktit duke filluar që tek neni 1 ku ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe rregullat normalisht që duhet të normohen nëpërmjet vendimeve. Unë e mbështes personalisht propozimin tuaj për ta ndryshuar formën e aktit nga udhëzim në vendim.

Znj. I. Nano: Ndërkohë më lejoni ti drejtohem edhe Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për shkak se është propozuesi i këtij akti.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.09.02.2021*

Z. I. Celibashi: Unë e gjej me vend propozimin dhe rekomandimin tuaj zonja Kryetare, për sa më takon mua, gjithësesi jeni ju ata që vendosni. Po unë mendoj që riorganizimi në formën e vendimit të këtij akti shkon në përputhje me përcaktimet e Kodit Zgjedhor mbi kompetencën e Komisionit Rregullator dhe ndoshta do të duhet që edhe unë si komisioner ta kisha prezantuar në formën e vendimit këtë projektakt, por gjithësesi në vlerësimin tuaj.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Të nderuar kolegë nëse nuk ka ndonjë koment tjetër, a mund ta votojmë meqë jemi që tek titulli dhe pastaj kalojmë në nenet me rradhë duke filluar nga neni 1 deri tek ai 13. Pra, propozimi im është që aty ku thuhet “udhëzim” që në titull e në nenin 1, në nenin 2, pra aty ku flitet për “udhëzim” të zëvendësohet me “vendim”.

Kush është dakord me këtë propozim?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj,z.Çakaj)

Kundër: S'ka!

Miratohet!

Do ti lutesha administratës të mbante shënim këtë propozim të sapo votuar. Duke qënë se është një akt i diskutuar tashmë jo vetëm nëpërmjet prezantimit të Komisionerit por iu është dërguar edhe partive politike më herët. Ndërkohë është një akt që në fakt nuk është një akt që vjen për herë të parë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Pra është një praktikë e konsoliduar tashmë. Në qoftë se kam konsensusin e kolegëve unë nuk do ti lexoja përmbatjen e secilit nen po do të lexoja vetëm titullin e nenit dhe më tej nëse ka propozime për shtesa apo ndryshime jeni të ftuar gjithë anëtarët e rregullatorit por edhe përfaqësuesit e partive politike. Të nderuar kolegë e kam mirëkuptimin tuaj lidhur me këtë çështje? Faleminderit! Dakord, jemi të gjithë dakord! Neni 1 i projektvendimit

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.09.02.2021*

tashmë, është “qëllimi” dhe “objekti”. Kemi për këtë nen së pari përfaqësuesit e partive politike më tej anëtarët e rregullatorit më tej ndonjë propozim apo koment? Në rregull mesa shoh nuk kemi komente. Ftojë anëtarët e Komisionit Rregullator të votojmë nenin 1 të projektvendimit “qëllimi” dhe “objekti”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj,z.Çakaj)

Kundër: S’ka!

Miratohet!

Neni 2, “përkufime” sigurisht janë sqarimi i termave që përdoren më së shumti në projektakt duke nisur nga “KQZ”, “KZAZ”, “VNV” , “Tavolinë Numërimi” “Mjediset jashtë VNV-së , ZAZ-së” e të tjera. Kemi komente ju lutem ose propozime për shtesa ndryshime më së pari po ia jap fjalën partive politike, zoti Kaso, zoti Kaziaj? Nuk kemi! Të nderuar kolegë? Nuk kemi komente apo propozime për nenin 2. Ju ftoj të votojmë nenin 2 sipas përmbatjes së propozuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj,z.Çakaj)

Kundër: S’ka!

Miratohet!

Neni 3, “parime të përgjithshme”. Edhe për këtë nen ftojë nëse ka komente apo propozime së pari përfaqësuesit e partive politike, atëhere zoti Kaso, zoti Kaziaj, kërkoj mirëkuptimin tuaj që mos tiu drejtohem pas çdo neni por nëse ju do të keni ndonjë propozim konkret ju lutem të kërkonit të merrni fjalën! Të nderuar kolegë për nenin 3, ju lutem? Nuk kemi propozime! Kështu që duhet të votojmë nenin 3, “parime të përgjithshme”!

Kush është dakord?

***Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.09.02.2021*

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj,z.Çakaj)

Kundër: S'ka!

Miratohet!

Kreu 2, "Caktimi dhe Kriteret Teknike të VNV". Neni 4, Vendndodhja e Vendit të Numërimit të Votave". Të nderuar kolegë nëse nuk keni propozime, ju ftoj të votojmë nenin 4 "Vendndodhja e VNV".

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj,z.Çakaj)

Kundër: S'ka!

Miratohet!

**Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI**



Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së

Komisioni Rregullator

Dt. 09.02.2021

Znj.I.Nano: Neni 5 "Kriteret teknike të VNV" si kundër edhe Komisioneri e theksoi më herët janë disa kriteret të cilat duhet të plotësojnë vendet e numërimit të votave, Kriteret me karakter teknik ku bëjnë fjalë qoftë furnizimin me energji, ndriçimin e të tjera po gjithashtu edhe me madhësinë e vendeve ku do të vendoset le të themi vendi i numërimit të votave. Këmi në diskutim paraprak lidhur me këtë nen meqë hyri dhe përfaqësuesi i PDIU zoti Sulo. Zoti Sulo sapo komunikova dhe me kolegët tuaj përfaqësues të partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim, nëse do të keni ndonjë propozim konkret jeni i ftuar për nenin përkatës nëse do të keni. Atëherë jemi tek neni 5 "Kriteret Teknike të VNV". Kolegë zoti Sulo kishit diçka? Atëherë ju ftoj të votojmë nenin 5 "Kriteret teknike të vendit të numërimit të votave".

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: Ska

Miratohet!

Vijmë në kreun 3 "Numëri i tavolinave të numërimit dhe pajisjeve logjistike në VNV", në fakt është një kre mjaft i rëndësishëm dhe kërkon një vëmendje të madhe më tej dhe nga zbatuesit e këtij vendimi. Ndërkohë neni 6 me titull "Kriteret për caktimin e tavolinave të numërimit në VNV" ku në disa pika të nenit 1 janë vendosur le të themi ai parashikimi ligjor i Kodit Zgjedhorë ku bëhet fjalë ku së paku 3 dhe jo më shumë se 10 tavolina në vendet e numërimit të votave. Kemi ndonjë diskutim lidhur me këtë nen ju lutem? Po zoti Çakaj!

Z.M.Çakaj: Atëhere duke qenë se në Kodin Zgjedhor e kemi si risi pra është futur vota parapëlqyese për kandidatët e Partive Politike si dhe nisur me qëllim, nisur dhe nga fakti dhe nga eksperiencia nga herët e kaluara por dhe nga formimi që ka

Zbardhi materialin e inçizuar

Albana NDOCI



Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së

Komisioni Rregullator

Dt.09.02.2021

bërë KQZ-ve. Në aktet nen ligjore të Kodit Zgjedhoë fillimisht numërohen votat e subjekteve të partive politike apo koalicioneve të partive politike dhe më pas do të vijojë për numërimin e votave të kandidatëve, pra votave parapëlqyese me qëllim rirënditjen qoftë brenda listës fituese ose qoftë rirënditjen jashtë listës fituese. Më pas për aplikimin e nenit përkatës të Kodit Zgjedhor për zëvendësimin e kandidatit sipas parashikimeve të këtij Kodi me qëllim që i shërbejnë procesit të shpejtimit të numërimit të votave. Duke qenë se prashikohet se numërimi i procesit të votave do të jetë një proces jo si më parë, pra do të kërkojë pak më shumë kohë. Unë do të propozoja që në nenin nr.6, pika 1 në të gjitha gerrat me përjashtim të germës së fundit. Pra në germen a në krye të fjalisë të vendosen jo më pak se 3 tavolina numërimi ku në territorin e ZAZ-së ka deri në 30 qendra votimi e me rradhë në të gjitha gerrat b, c, ç, d, dh, e, ndërsa germa ë e cila parshikon dhe tavanin e përcaktuar nga Kodi Zgjedhorë për numrin maksimal të tavolinave në vend numërimit të votave të rri siç është, pra të shtojmë këto fjalë "Jo më pak se". Nga ana tjetër në vijim dhe varësi të procesit është në diskrision të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve që në rast pas rasti për çdo ZAZ në se varijon që procesi do të jetë i ngadaltë apo do të ketë nevojë për shtim të tavolinave të numërimit është vendimarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në varësi të ecurisë të procesit të vendosi rast pas rasti.

Znj.I.Nano: Dakord, atëherë ju propozoni tek pika 1 e nenit 6 nga pika a deri në pikën e, të shtohet togfjalëshi "Jo më pak se". Me argumentin që ju dhatë për të mbajtur dyshememenë le të themi numërimin minimal që parashikon Kodi Zgjedhor dhe pastaj t'i lihet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me vendimarrjen e tij të mëparshme duke bërë vlersimet për çdo ZAZ, për të vendosur numërimin e caktuar të tavolinave të numërimit. Kolegë kemi ndonjë koment lidhur me propozimin e zotit

Zbardhi materialin e inçizuar

Albana NDOCI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.09.02.2021*

Çakaj ose ndonjë propozim tjetër? Atëherë më duhet të hedh në votim propozimin e zotit Çakaj? Nuk po e marr germë për germë por po themi nga germa a deri tek germa e të shtohet togfjalëshi "Jo më pak se". Të nderuar kolegë ju ftoj të votojmë propozimin e zotit Çakaj?

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: Ska

Miratohet!

Ju lutem administratës të mbajë shënim ndryshimet e sapo miratuara.

Kolojmë tek neni 7 "Paisjet logjistike në vendin e numërimit të votave". Koment, propozim për shtesë, ndryshim qoftë nga përfaqësuesit e Partisë Politike apo nga anëtarët e Rregullatorit ju lutem? Nuk ka propozime atëherë ju lutem anëtarëve të Rregullatorit të shprehen lidhur më këtë nen.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: Ska

Miratohet!

Kalojmë tek neni 8 "Instalimi teknologjisë mbështetëse në VNV". Sigurisht që ne kemi miratuar dhe një akt më herët po zonja Vukaj ka ndonjë koment ose propozim?

Znj.H.Vukaj: Në kushtet me të cilat ndodhemi ngrita dorën paraprakisht sepse nuk i dihet lidhjes po konçiduum në kohë. Atëherë unë këtu nëse më lejoni kam një propozim në pikën 4 të këtij neni. Në fund të fjalisë meqë ne risinë e Kodit e përshtatëm dhe sollëm një mjet sigurie si në cilësinë e kamerave që ne regjistrujmë por njëkohësisht e përshtatëm dhe me sigurinë që kërkohet për identifikimin e tavolinës për identifikimin e qendrës së votimit etj. Mendoj që në sinkron të

***Zbardhi materialin e inçizuar
Albana NDOCI***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.09.02.2021*

shtojmë mbas numërimit të fletëve të votimit edhe këtë togfjalësh ose pjesë të fjalisë si dhe numërin e qendrës së votimit.

Z.Y.Merkaj: Më fal po varjanti i fundit që kam nisur janë të pasqyruara të dyja edhe akti 5 dhe neni 8 të pasqyruara dhe të shkruara është neni i fundit që kam nisur dhe në orën 7 mbasdite. Punuam me varjantin e parë të draftit, varjanti i fundit që kemi nisur dhe.

Znj.H.Vukaj: Dakord administrata në qoftë se ka bërë një punë pararendëse dhe i është përshtatur ecurisë së kronologjisë të akteve dhe risisë që implementuam aq më mirë.

Znj.I.Nano: Në fakt ajo ç'ka zonja Vukaj theksoi dhe zoti Merkaj sapo e konfirmoi në fakt është pasqyrimi i një standarti të vendosur edhe më herët nëpërmjet një vendimmarrje të parën tonës në vitin 2021 që lidhet me përdorimin e kamerave në vendet e numërimit të votave është një standart tashmë i vendosur ku kamera duhet të fokusohet edhe tek numëri i qendrës së votimit. Kështu që nëse kjo gjë është kapërcyer atëherë zonja Vukaj nuk më duhet ta shtroj për votim.

Znj.H.Vukaj: Mendoj se duhet ta shtojmë për votim sepse nuk kemi verifikuar aktin dhe nëqoftëse kjo është pasqyruar pastaj ok.

Znj.I.Nano: Zonja Vukaj dakord do ta kaloj për votim, ndërkohë zoti Çaka kishte diçka ju lutem!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana NDOCI*



Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së

Komisioni Rregullator

Dt.09.02.2021

Z.D.Çaka: Unë mendoj që jam dakord dhe me propozimin e zonjës Vukaj si për përmbajtjen njëkohësisht dhe për faktin që ta kalojmë në votim sepse është e vërtetë edhe ajo që sekretari i përgjithshëm sapo citoj, por përta i përket nenit 5 ku neve bëme një ndryshim. Propozimi i sjellë nga administrata e KQZ-ve kishte një tjetër formulim, ndërkohë propozimi i zotit Çakaj ishte tjetër, sepse me të vërtete te neni 6 administrata ka cituar atë togfjalësh që "Jo më pak se" por kjo është cituar që në hyrje të fjalisë "Jo më pak se" duke përfshirë edhe pikën e që zoti Çakaj e sqaroji më së miri që është tavani i vendosur nga ligji. Ndërsa përta i përket pikës 8 është e vërtetë por është bërë një shtesë, ku thotë numrin e qendrës së votimit që po numërohet në numërin e grupit të numërimit dhe ndërkohë unë mendoj që përkufizimi që bëri zonja Vukaj është më i pranueshmi, sepse nëqoftëse do t'i referohemi dhe kamerës e cila do të vlerësojë fletën e votimit në pamjet filmike të saj mund ta pasqyrojë dhe brenda qendrës së votimit pra që po numërohet. Kështu që unë mendoj që të votohet propozimi i zonjës Vukaj. Në mënyrë që të jemi të saktë dhe me kolegët.

Znj.I.Nano: Dakord, atëherë kalojmë për votim propozimin e zonjës Vukaj që të shtohet numëri i qendrës së votimit ose të saktësohet më mirë të themi.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: Ska

Miratohet!

Kreu 4 organizimi i VNV neni 9 "Përgatitjet për VNV". Kolegë përfaqësues të partive politike keni ndonjë diskutim lidhur me këtë çështje me këtë nen? mesa shoh jo, unë duhet tju ftoj për votimin numër 9. Kush është dakord me nenin 9 ju lutem sipas përmbajtjes së propozuar?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana NDOCI*



Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: Ska

Miratohet!

Neni 10 "Skema organizative e funksionimit në VNV". Është një nen i gjatë i cili ka gjithashtu bashkëlidhur dhe një plan vendosje tip bashkëlidhur këtij vendimi do të thoja tashmë jo udhëzimi, por është një çështje që lidhet me zbardhjen. Zoti Sulo, zoti Kaziaj, zoti Kaso nëse keni diçka për këtë nen në aneksin që i bashkëlidhet. Të nderuar anëtarë të komisionit keni ndonjë koment për nenin? Atëherë të votojmë nenin 10. "Skema organizative e funksionimit të VNV që në fakt shkon bashkë me plan vendosjen tip në lidhjen 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Kush është dakord me nenin 10?

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: Ska

Miratohet!

Neni 11 "Prezantimi i vendit të numërimit të votave". Kolegë ose përfaqësues të partive politike nëse keni diçka lidhur me nenin 11. Në fakt është neni i fundit përmbajtësor, po zoti Çaka!

Z.D.Çaka: Unë do të kisha thjesht më shumë një sugjerim për të ndryshuar një term, tek neni 11 tek pika 4. Ku thotë në çdo rast organi që administron objektin, do të propozoja që fjala organi të ndryshojë me institucioni. Pra në çdo rast



institucioni që administron objektin ku është vendosur VNV-ja bashkëpunon për sigurimin e paisjeve. Pra të ndryshohet fjala nga "Organ" në "Institucion".

Znj.I.Nano: Kolegë keni ndonjë propozim tjetër ose ndonjë koment mbi nenin ose konkretisht mbi propozimin e zotit Çaka? Atëherë më lejoni të kaloj në votim për pikën 4 të nenit 11 të projektvendimit të propozohet fjala "Organi" të zëvendësohet me fjalën "Institucion"

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: Ska

Miratohet!

Znj.I.Nano: Atëherë kemi miratuar 13-të nenet e aktit, është momenti të miratojmë në tërësi aktin të cilin si parim për ne akti është votuar nga 5 anëtarët e Komisionit Rregullator. Kështu që të nderuar kolegë do t'u ftoja në.., ndjesë para se të kalojmë në miratimin në tërësi të aktit jam duke parë diçka që lidhet me formën e akteve tona. Në rastin e akteve tona ne kemi parashikuar edhe ankimin, e shoh që te akti mungon. Nuk di, është vlerësuar që nuk është një akt i ankimueshëm në Kolegjin Zgjedhor pasi në rregulloren tonë kemi parashikuar ankimin sipas rastit jo domosdoshmërisht në çdo akt. Mund t'i drejtohem zonjës Tenolli apo Komisionerit?

Z.I.Celibashi: Po është një zgjidhje ose nga përcaktimet tuaja për të vlerësuar nëse ky akt do të jetë akt i cili do të marrë.. është rasti dhe në akimimin e të tretëve.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.09.02.2021*

Znj.I.Nano: Të nderuar kolegë përpara se të kalojmë në votimin në tërësi mendoni që është vendi për të parashikuar një dispozitë lidhur me ankimin.

Z.M.Çakaj: Unë mendoj të ruajmë atë standartin që kemi mbajtur gjithmonë, madje t'i përmbahemi edhe Rregullores së organizimit dhe funksionimit të Komisionit Rregullator dhe në çdo akt për më tepër këtë që po e miratojmë në formën e vendimit, po në çdo akt sigurisht që ka palë për interes të ligjshëm nëse nuk shkon diçka në gjykimin apo interesin e ligjshëm të tyre kanë të drejtë të ankohen.

Z. I. Celibashi: Besoj në këtë akt duhet shtuar.

Znj.I.Nano: Dakord ta formalizojmë nëpërmjet një propozimi? Po zoti Çaka!

Z.D.Çaka: Jo, unë jam dakord edhe me sugjerimin tuaj edhe të zotit Çakaj që duke iu referuar edhe dispozitave që Rregullores së brendshme për organizimin e funksionimin e Komisionit Rregullator por dhe për të mbajtur të njëjtin standard lidhur me ato që ne kemi miratuar të jetë pjesë e këtij akti dispozita në lidhje me të drejtën e ankimit.

Znj.I.Nano: Atëhere, votojmë lidhur me këtë propozim për ndryshim. Atëhere të vendos dispozitën për ankimin ju lutem!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka!

Miratohet!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Albana NDOCI*



Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së

Komisioni Rregullator

Dt.09.02.2021

Kreu i 5 dispozita e fundit dhe hyrja në fuqi, neni 12 "Shfuqizimet me hyrjen në fuqi të këtij akti që po miratojmë shfuqizohet një vendimin i KQZ-së i 2015" dhe neni 13 "Hyrja në fuqi si zakonisht vendimet e Rregullatorit hyjnë në fuqi menjëherë dhe publikohen në faqen zyrtare të KQZ-së. Atëherë do t'u ftoja për të votuar së pari nenin 12 kolegë!

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: Ska

Miratohet!

Kush është dakort për nenin 13?

Znj.H.Vukaj: Vetëm duhet zëvendësuar fjala "udhëzim" me fjalën "vendim"

Znj.I.Nano: Po, po në të gjithë aktin,

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: Ska

Miratohet!

Atëherë është momenti që të votojmë aktin në tërësi! Akti është diskutuar në parim, nen për nen, ka pësuar disa ndryshime gjatë diskutimit nen për nen. Të nderuar kolegë ju lutem të votojmë aktin në tërësi!

Kush është dakord me aktin pas ndryshimeve që pësoi?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka!

Miratohet!

Zbardhi materialin e inçizuar

Albana NDOCI



Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së

Komisioni Rregullator

Dt.09.02.2021

Faleminderit! Kemi miratuar vendimin për kriteret e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave. Duke iu falenderuar për pjesëmarrjen, duke qenë se nuk kemi ndonjë pikë tjetër në rendin e ditës, nëse ndonjë nga anëtarët e Komisionit Rregullator, Komisioneri, apo përfaqësuesit e partive politike nuk kanë diçka për të thënë! Atëhere e konsideroj të mbyllur mbledhjen e Komisionit Rregullator, ritakohemi në mbledhjet e ardhshme.

Vendimi nr.3

Zbardhi materialin e inçizuar

Albana NDOCI

